

## UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 3, datë 26.3.2026

### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 22.11.2022, “PËR TARIFAT E TË ARDHURAVE DYTËSORE TË APLIKUESHME NGA INSTITUCIONET VARTËSE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar; të neneve 7, 44, 125, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 16, 18, 21, 24, 28, 33 dhe 37, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; të neneve 14 dhe 32, të ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve ushqimore dhe bujqësore”; të ligjit nr. 87, datë 14.2.2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërësive të ullirit”; të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000, “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”; të nenit 11, të ligjit nr. 17/2020, “Për produktet plehëruese”; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr. 86/2022, datë 22.12.2022, “Për vreshtarinë dhe verën”; të pikës 10, të VKM-së nr. 335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; të pikës 9, të VKM-së nr. 223, datë 13.4.2001, “Për vlerësimin cilësor të markave të cigareve të pranishme në tregun shqiptar”; të VKM-së nr. 515, datë 19.7.2006, “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”; dhe të VKM-së nr. 432, datë 28.6.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”; si dhe të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Programin e Auditimit nr. 123/3 prot., datë 20.1.2025, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministri i Financave

#### UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 19, datë 22.11.2022, “Për tarifatat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Tarifatat e përcaktuara në këtë udhëzim, nuk aplikohen për testimin e varieteteve nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, për regjistrim në Katalogun Kombëtar, përfshirë regjistrimin me testim dhe regjistrim me DUS nga UPOV dhe CPVO, sipas pikave 73 dhe 74, të tabelës “Tarifat për testimin e varietetit për regjistrim në Katalogun Kombëtar”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Në kreun III, në tabelën me titull “Tarifat e analizave fiziko-kimike të disa produkteve ushqimore”, pas pikës 15.3 shtohet pika 15.4, me këtë përmbajtje:

| 15.4   | Uji i ambalazhuar       | Vlera në lekë |
|--------|-------------------------|---------------|
| 15.4.1 | Mbetja e thatë në 180°C | 720           |
| 15.4.2 | pH                      | 320           |
| 15.4.3 | Fortësia e përgjithshme | 800           |
| 15.4.4 | Kalcium                 | 600           |
| 15.4.5 | Magnezi                 | 600           |
| 15.4.6 | Bikarbonatet            | 600           |
| 15.4.7 | Kloruret                | 700           |
| 15.4.8 | Gazi karbonik me titrim | 650           |
| 15.4.9 | Gazi karbonik me aparat | 200           |

3. Në kreun II, në tabelën me titull “Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve (ESHFF)”, pika 4 e tabelës “Tarifat për certifikim zyrtar për etiketat, etiketimin dhe rietiketimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor”, ndryshohet si më poshtë:

*“Certifikimi dhe lëshimi i etiketave zyrtare për farërat e bimëve të arave, foragjereve, patates, të prodhuara në vend, për çdo 1–100 kV (të certifikuar): 500 lekë.”*

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

**Andis Salla**

MINISTËR I FINANCAVE

**Petrit Malaj**